



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,
mbajtur më 30.4.2025.**

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i Komitetit, Nora Kelmendi (VV), Mirsad Vitia (VV), Arbnora Berisha (VV), Gëzim Sveçla (VV), Jeta Rafuna (LDK), Milazim Vitija (LDK), Dhurata Jahaj - Retkoceri (LDK), Shegë Beqiri - Badivuku (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Bahri Gashi (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Brahim Mehmetaj - drejtor i Drejtorisë së Pronës, Samir Shahini - drejtor në Drejtorinë e Arsimit dhe Fatos Dibra- udhëheqës i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësisht rregullues Çagllavica;
3. Raport finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2025 (TM1);
4. Propozim – vendimi lidhur me Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2025-2026;
5. Propozim – vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit për vitin 2025;
6. Propozim – vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për Artin dhe Kulturën 2026-2031;
7. Propozim – vendimi për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;

8. Propozim – vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës NPL-së “Trafiku Urban”, SH.A;
9. Propozim – vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës;
10. Propozim – vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Këshillit Prokurorial të Kosovës;
11. Propozim – vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

Gëzim Sveçla: - tha se rendi i ditës për seancat e Kuvendit përgatitet nga kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Kryetarin. Por siç e dimë të gjithë, pika e dytë e rendit të ditës nuk ka kaluar tash e gjashtë muaj dhe kjo po paraqitet si pengesë që mos të kalojnë edhe pikat tjera të rendit të ditës. Sveçla tha, propozoj që pika e dytë të kalojë si pikë e fundit e rendit, para pikës pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi: - tha se rendi i ditës është përgatitur në koordinim, me kabinetin e kryetarit dhe me insistimin e tyre është vendosur që pika e dytë e rendit të ditës, të jetë Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues “Çagllavica”.

Jeta Rafuna: - tha se nuk pajtohem me propozimin, për shkak se hartimi i Planit të hollësishëm rregullues për “Çagllavica”, është mjaft i rëndësishëm për një pjesë të qytetit të Prishtinës dhe të gjithë kanë të drejtën e votimit, qoftë për apo kundër votimit, pastaj për të vazhduar me pikat tjera të rendit të ditës.

Leutrim Retkoceri: - tha se ne si grup i Partisë Demokratike të Kosovës, nuk e mbështesim as për trajtim këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo për shkak të respektit ndaj seancës e mbështesim propozimin, që kjo pikë të vendoset në fund të rendit të ditës.

Bahri Gashi: - tha se pika e dytë e rendit të ditës “Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëM rregullues “Çagllavica”, nuk duhet të largohet nga rendi i ditës sepse fillimisht duhet të trajtohet në Kuvend, pastaj me votë mundemi me vendos se a duhet apo jo të kalojë.

Leutrim Retkoceri: - tha se propozoj që pika e raportit finansiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2024, të kthehet prapë dhe të jetë në rend të ditës, e cila është për shkak të mungesave të kourumit nuk është diskutuar fare në Kuvend. Retkoceri tha se për shkak të situatës dhe shqetësimeve të vazhdueshme të qytetarëve me qentë endacakë, kërkoj që në seancën e ardhshme të Kuvendit të jetë si pikë e rendit e ditës diskutim mbi situatën me qentë endacakë në Kryeqytet dhe të dërgohet nga drejtoritë përkatëse një raport në lidhje me situatën.

Propozimi nga Gëzim Sveçla, që pika e dytë e rendit të ditës “Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues “Çagllavica”, të kalojë si pikë e parafundit, votohet me 6 (gjashtë) për, 3 (tre) kundër dhe asnjë abstenim.

Propozimi për pikë të rendit të ditës nga Leutrim Retkoceri, “Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2024”, votohet me 7 (shtatë) vota për, (0) zero kundër dhe (0) zero abstenime.

Propozimi i tretë nga Leutrim Retkoceri, për pikë të rendit të ditës “Diskutim mbi situatën lidhur me qentë endacakë në kryeqytet”, votohet me 7 (shtatë) vota për, 0 (zero) kundër dhe 0 (zero) abstenime.

Bahri Gashi: - tha nëse ka mundësi ta thirrni Fatos Dibrën - udhëheqësin e Zyrës ligjore sepse rendi i ditës hartohet nga kryetari dhe kryesuesi, ndërsa po ndryshohet nga Leutrimi dhe Gëzimi.

Leutrim Retkoceri: - tha se pikërisht për shkak të opinionit ligjor, i cili i ka jep të drejtë Drejtorisë së Shërbimeve Publike në raport me Ndërmarrjen “Pastrimi”, sot qytetarëve iu shpërndahen fatura me vërejtje të bashkëngjitur për përmbarim, ndërsa në anën tjetër në bazë të rregullores kompania publike iu dërgon fatura për pagesë. Ai tha se qytetarët janë përballur me një situatë të vështirë nga të dy anët, duke pezulluar me të drejtë edhe pagesat e tyre dhe përgjegjësia i mbetet Komunës së Prishtinës ta bëjë një zgjidhje. Retkoceri tha se propozimi për subvencionimin e borxhit të vjetër duhet të mierret parasysh, të diskutohet në asamble ta gjejmë një zgjidhje, mos të mbeten qytetarët pa shërbime për shkak të përplasjeve në mes Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe kryshëfit të Ndërmarrjes “Pastrimi”, deri në zgjidhjen dhe sqarimin e situatës nga gjykata.

Valbona Makolli: - tha se sa i përket aspektit finansiar të pastrimit deri më 30.12.2024, asnjë faturë që është sjellë për pagesë nuk ka mbetur borxh derisa ka pas kontratë dhe nëse ka ndonjë borxh që na ka mbetur, le ta dërgojnë në DSHP ose tek ne dhe e shohim. Drejtoresha tha, sa i përketë subvencioneve në raportin e TM1, ju tregoj rastet përmbarimore ku për shkak të mosaprovimit të buxhetit në Kuvendin e Kosovës, është hera e parë që në nivelin lokal në rastet përmbarimore marrin edhe shërbimet e investimeve kapitale dhe komunalitë.

Leutrim Retkoceri: - tha se subvencionimi ka të bëjë me borxhet e vjetra të ndërmarrjes, prandaj ta shqyrtojmë si Kuvend dhe para deponisë ta kemi një vendim i cili do t'i garantonte subvencionimin e borxhit dhe kur të lirohet buxheti i komunës të jenë mjetet e garantuara. Leutrimi tha se në të kundërtën deponia i mbyll dyert, operatorët i ndalin shërbimet me naftë dhe qytetari mbetet pa shërbim.

Bahri Gashi: - tha se pajtohem me propozimin e Leutrimit, vetëm se paraprakisht kërkoj që ndërrmarja të na sjellë një raport të detajuar për të gjitha të hyrat dhe të dalat nga kompania dhe të shohim se si është e mundur në të gjitha vendet tjera kompanitë e pastrimit janë fitimprurëse, ndërsa vetëm tek ne kjo kompani sjell humbje. Gashi tha se po ta kemi një raport të tillë do analizojmë dhe diskutojmë së bashku si asamble, ta shohim se kush është fajtori për këto humbje dhe ta sqarojmë njëherë që mos të na shfaqen çdoherë probleme të tilla me kompaninë.

Leutrim Retkoceri: - tha se pajtohet me kërkesën dhe realisht të gjitha ndërmarrjet në Komunën e Prishtinës janë të obliguara për raportim para asamblesë së kryeqytetit. Retkoceri tha se nëse pajtohen edhe anëtarët tjerë të Komitetit për Politikë dhe Financa, t'i propozojmë dy pikat për rend të ditës. E para "Diskutim mbi raportin e Ndërmarrjes Pastrimi" dhe e dyta "Rekomandim për subvencionim të ndërmarrjes".

Bahri Gashi: - tha se nuk është e nevojshme t'i kemi dy propozime për Kuvend, së pari ta kemi një raport me shkrim nga drejtori me informacione më të plota rreth këtyre problemeve dhe paralelisht edhe një raport nga menaxhmenti i ndërmarrjes, pastaj duke u bazuar në këto dy raporte krijojmë debatin sepse jo të gjithë ne jemi të informuar sikur është Leutrimi. Gashi tha se pas diskutimit të shohim nëse vendosim për të dalë me ndonjë rekomandim për subvencionim të ndërmarrjes, por së pari të shohim arsyet që kanë sjell deri në këtë gjendje.

Kryesuesi: - tha se raportimet për ndërmarrjet i kemi pasur në rend të ditës ashtu siç është paraparë në planprogramin e punës së Kuvendit edhe në mbledhjet e kaluara, mirëpo për shkak të mungesës së kuorumi dhe mbylljeve të mbledhjeve nuk kemi ardhur asnjëherë deri te pika e raportimit. Kryesuesi tha se duhet të vendosim, se a duhet të jetë një apo dy pika të propozuara për rend të ditës.

Jeta Rafuna: - tha se pajtohet me atë se edhe në mbledhjet e kaluara kemi pasur pika rrëth raportimit të ndërmarrjeve, por për shkak të mungesave të kuorumi nuk kemi mundur të raportojmë. Jeta tha se propozoj nëse pajtohen edhe kolegët që raportimi të bëhet nga kryeshefat e ndërmarrjeve, sepse ka ndërmarrje që aksionarët nuk janë duke funksionuar dhe bordi s'po ka se kujt t'i raportojë.

Bahri Gashi: - tha se kërkoj nga kolegët që në këtë seancë ta kemi si pikë të parë diskutimin për ndërrmarjen dhe të merremi seriozisht me problemet e pastrimit, ta kemi menaxhmetin e kësaj ndërmarrjeje për raportim në asamble, të cilët nuk kanë ardhur asnjëherë për raportim edhe pse janë të detyruar, pastaj të fillojmë me radhë me të gjitha ndërmarrjet tjera të Komunës së Prishtinës.

Propozimi nga Bahri Gashi, Raporti i NPL "Pastrimi", votohet me 7 për, zero kundër dhe zero abstenime.

Propozimi nga Leutrim Retkoceri, Subvencionimi i borxheve të vjetra në NPK "Pastrimi", votohet me 5 vota për, zero kundër dhe zero abstenime.

Propozimi nga Gëzim Sveçla, Raporti i Ndërmarrjes "Termokos", votohet me 6 për, zero kundër dhe zero abstenime.

Bahri Gashi: - tha se kërkoj një interpretim nga Zyra ligjore edhe pse atë tash e sa herë veç e kemi si informatë. Gashi tha se në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa po shtojmë pika për rend të ditës, po i largojmë a kemi të drejtë a jo dhe a jemi duke bërë ndonjë shkelje?

Fatos Dibra, tha se ju kam informuar disa herë në mbledhje edhe përmes emailit zyrtar që Komiteti për Politikë dhe Financa nuk ka kompetencë të shtojë apo largoje pika nga rendi i ditës, sepse rendin e ditës e hartron kryesuesi në koordinim me kryetarin e komunës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024.

Kryesuesi tha se u përkrah Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024 dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e tretë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2025 (TM1).

Valbona Makolli: - tha se raportin e kemi dorëzuar në bazë të ligjit që është në fuqi dhe kam njoftuar që për shkak të bazës që është të miratimit në afatet e caktuara sipas Qarkores së Ministrisë së Financave dhe mosaprovimin e buxhetit në kohë në Kuvendin e Kosovës për shkak të rr Ethanave tash të njohura, ligji parashev kur Kuvendi është funksional, kurse kur Kuvendi nuk është funksional nuk e parashev dhe jemi në një situatë të vështirë financiare. Ajo tha se ato mjete që veç i alokojmë të hyra vetanake të cilat jemi duke i mbledhur, ato automatikisht nga Ministria e Financave për rastet përbartimore të formës të prerë i merr dhe jemi në një situatë jashtëzakonisht të vështirë financiare.

Kryesuesi tha se u përkrah Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2025 (TM1) dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e katërt

Propozim – Vendimi lidhur me Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2025-2026

Kryesuesi: - tha se për këtë pikë do të diskutojmë në seancën e Kuvendit.

Pika e pestë

Diskutim për qentë endacakë.

Kryesuesi: - tha se, për këtë pikë do të diskutojmë në seancën e Kuvendit.

Pika e gjashtë

Diskutim mbi raportin e Ndërmarrjes “Pastrimi”.

|

Kryesuesi tha se, për këtë pikë do të diskutojmë në seancën e Kuvendit.

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për subvencionimin e borxhit të vjetër NPL “Pastrimi”.

Kryesuesi: - tha se për këtë pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e tetë

Propozim – vendimi për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvacioneve nga Komuna e Prishtinës.

Kryesuesi: - tha se edhe për këtë pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e nëntë

Raporti i Ndërmarrjes “Termokos”

Kryesuesi: - tha se edhe kjo pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e dhjetë

Propozim – vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025.

Kryesuesi: - tha se për këtë pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozim – vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031.

Kryesuesi: - tha se për këtë pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e dympëdhjetë

Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvacioneve nga Komuna e Prishtinës.

Kryesuesi: - tha se për këtë pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e trembëdhjetë

Propozim – vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës NPL “Trafiku Urban”, SH.A.

Brahim Mehmetaj: - drejtor tha se, duke e marr parasysh rëndësinë e vazhdimit të kësaj kontrate me trafikun urban, propozoj që kjo pikë mos me u heq nga rendi i ditës.

Kryesuesi: - falemnderit drejtor. Kjo pikë mundet me u propozuar në seancë, a jeni që të mbetet apo të largohet? Kabineti e ka propozuar, e ka vë emrin e Leutrimit, ndërsa Leutrimi po thotë pa lejen time e kanë bërë. Leutrimi po thotë me heq, e kjo ka mundësi me u fut në seancë. Nuk ka problem le te fusin këtë pikë në seancë. Mirë lëre, dikush nga kabineti vjen edhe e prezanton.

Nora Kelmendi: - tha se ne për këtë pikë nuk kemi pranuar çertifikatë të pronës, kopje të planit dhe skicë grafike. Po ashtu në këtë propozim-vendim ka edhe disa gabime të tjera dhe kërkoi që ato të korrigohen dhe në seancë të na sillet si dokumentacion i kompletuar.

Kryesuesi: -tha se edhe kjo pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e katërmëdhjetë

Propozim – vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës.

Brahim Mehmetaj- drejtor tha se nga MPB përkatesisht nga Policia e Kosovës kemi marrë kërkësen që ti vazhdohet dhënia në shfrytëzim e një pronës të cilën e kemi dhënë në shfrytëzim para 3 viteve dhe tanë i ka skaduar afati. Ne kemi propozuar që t'i jepet në shfrytëzim në afatin prej 10 viteve deri sa ata të bëjnë një zgjidhje dhe pastaj me dalë në prona të veta, ku është paraparë të gjitha institucionet me kalua andej nga Prishtina e Re.

Nora Kelmendi- kërkoi të dijë se, a ekziston kontrata për shfrytëzim nga Këshilli Prokurorial, se nëse e shikon certifikatën e pronës atëherë kjo nuk është në shfrytëzim prej Këshillit Prokurorial, pra çertifikatë të pronës nuk ekziston askund dhe se a po ju jepni tokën apo objektin, çertifikatë të objektit nuk keni, objekti që nuk ekziston si i'a jepni në shfrytëzim. Gjithashtu certifikata e pronës nuk përputhet me kopjen e planit, çertifikata e pronës ka ndarje, ndërsa kopja e planit është a ndarje.

Kryesuesi -tha se edhe kjo pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e pesëmbëdhjetë

Propozim-vendimi për caktimin e Komisionit për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Sami Shahini, drejtor: - tha se për këtë vit ky komision parashihet që t'i mbulojë 13 pozita të drejtorëve në periudha të ndryshme për shkak se ju e dini angazhimet e drejtorëve janë me kontratë dhe mandate e që përfundojnë në kohëra të ndryshme. Komisionet për drejtorë zakonisht janë ad'hoc dhe përfundon mandati i tyre në përfundim të procedurës për të cilën ata janë të thirrur, pra përfundon me përzgjedhjen e 13 drejtorëve.

Leutrim Retkoceri: - kërkoi të dijë se a është në rregull që i njëjtë komision me qenë për tri kategoritë si për institucionë parashkollore si për drejtorë të shkollave të mesme dhe si për drejtorë për shkolla profesionale, që nuk mendoj që një ekspert mundet me i mbuluar të gjitha dhe pse nuk është aplikuar vazhdimi i mandatit të anëtarëve të komisionit që kanë qenë të zgjedhur me Ambasadën Britaneze për të vazhduar rekrutimin e drejtorëve. Nuk mendoj që një person mundet me i kryer tri punë në të njëjtën kohë, ndërsa sa i përket asaj që ka mandat ose nuk ka mandat, unë nuk e thash të njëjtën gjë, unë e thash që pse nuk janë ekspertët e njëjtë që kanë bërë, janë certifikuar ose janë përzgjedhur nga Ambasada Britaneze, të cilët me sa e di kanë pas një performancë të përzgjedhjes së drejtorëve jopolitikë nëpër institucionë shkollore. Ideja është që të paktën në arsim të mos kenë ngarkesa politike, por të jetë më e mira e mundshme sepse ka të bëjë me fëmijët.

Sami Shahini: - tha se mandati i këtij komisioni nuk mundet me qenë shumëvjeçar ose përtej mandatit që e saktëson rregullorja, që ka të bëjë me shpallje të një konkursi. Janë disa kritere të qarta në rregullore të cilat parashohin kualifikimin e personave që duhet të jenë pjesë. Sa i përket vlerësimit që ju e shfaqet për ish - anëtarët e komisionit si ekspertë që kanë qenë, unë kam perceptim dhe informata tjera prej atyre që keni ju, megjithatë nuk ka ndal askush me aplikuar në thirrjet që janë shpall dy herë. Nuk e kemi pas numrin e duhur të kandidatëve dhe për atë kanë dështuar thirrjet, për atë edhe nuk kemi drejtorë të jashtëm, kemi drejtorë në komision.

Bahri Gashi: - tha se bazuar në disa informacione të cilat kanë rrjedhur nga portalet e ndryshme, janë bërë disa keqpërdorime në një çerdhe të Prishtinës dhe për këtë çështje kërkoi nga z. Shahini që në seancën e Kuvendit të jepet një përgjigje se si kanë ndodhur ato parregullsi.

Gëzim Sveçla: - tha se është me të vërtetë shqetësim i qëlluar i ngritur nga z. Gashi dhe është produkt i veprimeve të mëhershme të kësaj qeverisjeje. Ata kanë qenë në dijeni që nuk mundem me kalu një buxhet me kohë, kurrë nuk kanë marrë veprime që kishin me i siguruar numrat që buxheti mundet me kalu në kohën e paraparë edhe nuk ishim marrë këtu sot ku jemi. Plotësisht pajtohem me këtë konstatimin e fundit z. Gashi, që 4 vite kështu është gjendja jo e mirë gjithandej.

Kryesuesi: - tha se edhe kjo pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Pika e gjashtëmbëdhjetë

Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues Çagllavica

Kryesuesi: - tha se edhe kjo pikë do të diskutohet në seancën e Kuvendit.

Mbledhja mbaroi në orën 11:30.

Procesmbajtësi
Arton Brahimë

Kryesues i mbledhjes
Milazim Vitija
(anëtar i më i vjetër)

